



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.24

8 mars

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.96, datë 21.2.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.236, datë 10.5.1993 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë”	403
Vendim i KM nr.97, datë 21.2.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Ura e Bunës- Muriqan.....	403
Vendim i KM nr.104, datë 28.2.2007	Për një shtesë në vendimin nr.27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”	406

VENDIM
Nr.96, datë 21.2.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.236, DATË 10.5.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E FURNIZIMIT ME UJË PËR PËRDORUESIT
FAMILJARË DHE JOFAMILJARË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.236, datë 10.5.1993 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Konsumatorët jofamiljarë, shtetërorë ose privatë, që furnizohen me ujë të pijshëm, i sigurojnë, administrojnë dhe ruajnë vetë matësit e ujit. Në rast dëmtimi konsumatori jofamiljar duhet të njoftojë, me shkrim, ndërmarrjen e ujësjellësit dhe të marrë masa për ta zëvendësuar matësin e ujit, brenda 30 ditëve. Pagesa e konsumit të ujit për këtë periudhë bëhet në bazë të normave të konsumit mesatar mujor të konsumatorit. Nëse ndërmarrja e ujësjellësit nuk njoftohet për dëmtimin e matësit ose matësi nuk vendoset brenda afatit të caktuar, konsumatori (jofamiljar) detyrohet të paguajë konsumin mesatar të ujit me 5-fishin e çmimit.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Në rast se konsumatori nuk paguan detyrimin, që ka ndaj ndërmarrjes së ujësjellësit, në bazë të kontratës për furnizimin me ujë, detyrohet të paguajë një shtesë për kamatëvonesë 0.5 për qind të vlerës së konsumit të ujit për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10 për qind.

Nëse pagesa nuk kryhet brenda 30 ditësh, ndërmarrja e ujësjellësit ndërpret furnizimin me ujë.

Shpenzimet e kryera nga ndërmarrja e ujësjellësit, për rilidhjen e konsumatorit me rrjetin e furnizimit me ujë, të përballohen nga konsumatori.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.97, datë 21.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI DHE REHABILITIMI
I SEGMENTIT RRUGOR URA E BUNËS-MURIQAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Ura e Bunës-Muriqan.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 1 800 m² tokë/arë, të vlerësuar me çmimin 1 000 lekë/m², me vlerë 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekë; sipërfaqen 60 m² tokë/truall, me çmimin 1 400 lekë/m², me vlerë 84 000 (tetëdhjetë e katër mijë) lekë; për objekte, me vlerë 1 981 199 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 3 865 199 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 865 199 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t'u përdorur për shpronësimet.
 5. Shpenzimet procedurale, në shumën 175 500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1.3.2007 dhe të përfundojë më 31.3.2007.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Plotësim dokumentacioni" ose "Mungon kartela e pasurisë", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Deri në këtë çast, paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR URA E BUNËS-MURIQAN

Nr.	Emri	Pasuria	Sipërfaqja tokë/ arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Sip.tokë truall	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Objekte	Vlera në lekë	Totali në lekë	Shënime
1.	Asim Duli	378	30	1000	30 000						30 000	
2.	Qamil Shega	870/2							32	410 621	410 621	
3.	Nazmi Brahim Hoti	209	220	1 000	220 000	60	1 400	84 000	180	1 570 578	1 874 578	
4.	Nazmi Brahim Hoti	207/2	160	1 000	160 000						160 000	
5.	Bahri Ymer Vulashi	120/7	38	1 000	38 000						38 000	
6.	Halit Kasem Vulashi	120/7	38	1 000	38 000						38000	
7.	Tahit Bajram Kasemi	120/6	473	1 000	473 000						473 000	
8.	Muhamet Hasan Alia	120/1	62	1 000	62 000						62 000	Plotësim dokumentacioni
9.	Fahri Veli Hoti	112/10	36	1 000	36 000						36 000	
10.	Nail Veli Hoti	112/9	46	1 000	46 000						46 000	
11.	Xhevat Abdulla Neli	228/1	46	1 000	46 000						46 000	
12.	Dul Isa Laja	228/13	58	1 000	58 000						58 000	Mungon kartela e pasurisë
13.	Bashkëpronarët Laja	228/12	63	1 000	63 000						63 000	Mungon kartela e pasurisë
14.	Shefqet Hamz Laja	228/4	100	1 000	100 000						100 000	Mungon kartela e pasurisë
15.	Eljaz Jakup Hoxha	138	90	1 000	90 000						90 000	
16.	Xhevair Isuf Fusha	137/3	340	1 000	340 000						340 000	
	Shuma		1 800		1 800 000	60		84 000		1 981 199	3 865 199	

Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 865 199 lekë

VENDIM
Nr.104, datë 28.2.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.27, DATË 19.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES
SË KONCESIONEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 1 të kreut VI “Hartimi i dokumenteve të procedurës konkurruese” të vendimit nr.27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në të gjitha koncesionet, komisioni, në kriteret e vlerësimit të ofertave, përfshin vlerën e pagave (royalties), që ofertuesit i japin autoritetit kontraktues, për një projekt koncesionar të caktuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 6.3.2007
 Doli nga shtypi më 8.3.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Grafon”
 Tiranë, 2007

Çmimi 8 lekë